



DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI 04/07/2022

08- Nr. 129

Datë; 04.07.2022

REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY OF SUHAREKA REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
DATE / DATA / DATUM / RECEIVED			
What is the Date / Data / Datum	What is the Number	What is the Date / Data / Datum	What is the Value
08	104	30/07/22	€

THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohen fermerët e komunës së Suharekës se Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2022, do të vazhdoj të mbështesë sektorin e blegtorisë përmes subvencionimit të qumështit nga 0.03€litër për gjashtëmujorin e parë 2022.

Kriteret që duhet ti plotësojnë fermerët \ aplikuesit:

1. Të jenë banorë të Komunës së Suharekës.
2. Të jenë të regjistruar si fermerë në sistemin elektronik Efr-së - NIF dhe në sistemin e identifikimit të kafshëve në AUV.
3. Të kenë mbi 3 lopë qumështore.
4. Kontrata e nënshkruar nga qumështoret e licencuara.
5. Dëshmi për sasinë e dorëzuar të qumështit në ndonjëren nga pikat e grumbullimit të qumështit apo qumështore të licencuar.
6. Të dorëzojnë së paku 3000 litra qumësht për gjashtëmujorin e parë \ 2022.

Dokumentet e nevojshme për Aplikim

1. Kopja e letërnjoftimit.
2. Kopja e listës së verifikimit të gjedheve të lëshuar nga sektori për identifikimin dhe regjistrimin (I&R) në kuadër AUV-së.
3. Kopja e kontratës për furnizim me qumësht të lëshuar nga qumështoret e licencuara.
4. Konfirmimi i bankës.
5. Dëshmi e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të dorëzuar.
6. Vërtetimi për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore.
7. Vërtetimi i tatimit në pronë.

Informatat dhe data e Aplikimit

Aplikimin fermerët mund ta bëjnë në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari në Komunën e Suharekës

Afati i aplikimit fillon prej datës **04.07.2022** deri me datën **18.07.2022**

Aplikacionet që dorëzohen pas afatit nuk shqyrtohen.

Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari


Ardian Kotorri